




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-15928/20 datë: 19.08.2020



Npi – 01/189 datë: 27.08.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 27.08.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 27.08.2020 (e enjte) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Syla, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nënkryetari, z.Rahman Jakupi; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Zyrtari Ligjor, z.Lulzim Muharremi; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve të KPF-së më: 08.05.2020, 03.06.2020, 09.06.2020, 29.06.2020,
2. Draft-Buxheti per periudhën 2021-2023,
3. Shqyrtimi i Raportit buxhetor për periudhën Janar – Qershor 2020,
4. Draft-Rregullore Komunale për mbrojtjen e Fëmijës (pas diskutimit publik),
5. Shqyrtimi i Kërkesave.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapi diskutimin për Rendin e Ditës, Kryesuesja e njoftoi KPF-në që të mos procedohet me Draft Buxhetin që është kërkesë nga Ministria e Financave, kështu që propozoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës që është propozuar, në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, kërkojë që informata për Raportin e Auditorit të përgjithshëm të trajtohet edhe në KPF-ë.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, fillimisht unë i Urojë martesën Kryesueses. Unë i përkrahu propozimet e bëra nga Kryesuesja por e anashkaloj propozimin e Naimit për shkak se e sqaroi Kryesuesja se kjo është Informatë e jo Raport.

z.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Përshëndetje, Qarkorja është ardhur më datën: 11.08.2020 për buxhetin. Tash ne e kemi marrë një E-mail nga Ministria e Financave për me shty Planin Buxhetor.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Rendin e Ditës pa pikën 2. “Draft-Buxheti per periudhën 2021-2023”, si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesve. të KPF-së më: 08.05.2020, 03.06.2020, 09.06.2020, 29.06.2020,
2. Shqyrtimi i Raportit buxhetor për periudhën Janar – Qershor 2020,
3. Draft-Rregullore Komunale për mbrojtjen e Fëmijës (pas diskutimit publik),
4. Shqyrtimi i Kërkesave.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbaleve të KPF-së më: 08.05.2020, 03.06.2020, 09.06.2020, 29.06.2020
Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Unë kam një vërejtje të përgjithshme, mendoj se duhet me ndërmarrë diçka për mungesën e procesverbaleve. Nuk ka mundësi që sot ti mbajmë mend procesverbalet që nga muaji Maj. Katër procesverbale janë grumbulluar, kështu nuk shkon, duhet të ndërmerret diçka që ti ndihmohet Sekretarisë së Kuvendit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi katër Ekstrakt Procesverbalet e mbledhjeve të KPF-së të mbajtura më: 08.05.2020; 03.06.2020; 09.06.2020; 29.06.2020.

Pika 2

Shqyrtimi i Raportit buxhetor për periudhën Janar – Qershor 2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, lexoi raportin të ndarë sipas tabelave në kategoritë ekonomike. Dokumentin e raportit e kemi në formë të shkruar dhe e keni marrë me kohë. Unë i mirëpres pyetjet dhe sugjerimet e juaja, (shih dokumentin).

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” vendosi t’i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Raportit buxhetor për periudhën Janar – Qershor 2020.

Pika 3

Draft-Rregullore Komunale për mbrojtjen e Fëmijës (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Nënkryetari.

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, lidhur me diskutimin publik të kësaj propozim-rregullore, kemi pas udhëzim që të mos ketë tubime më shumë se 5 persona. Nuk kemi ndonjë propozim konkret për këtë rregullore. Unë i mirëpres pyetjet ose propozimet e juaja. Ju ftoj që ta votoni këtë rregullore sepse është në të mirën e qytetarëve e para së gjithash në të mirën e fëmijëve.

z.Ruzhdi Jashari; Konsideroj se është një dokument i mirë, dhe shumë i rëndësishëm për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ne propozimet dhe vërejtjet tona do ti prezantojmë në seancën e Kuvendit.

z.Naim Zejna; Është mirë që edhe Komuna jonë po e miraton një rregullore të tillë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Unë e kam lexuar draft-rregulloren dhe nuk kam vërejtur ndonjë parregullsi.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, e përkrahu plotësisht këtë dokument të rëndësishëm, dhe gjithsesi që do ta votoj.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi t’i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Rregullores Komunale për mbrojtjen e Fëmijës.

Pika 6

Shqyrtimi i Kërkesave

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi kërkesat:

1. z. Bekim Sinani, përfaqësues i firmës “DONI FRUITS” Rr.”Driton Islami” p.n. Ferizaj, Kërkesa Nr.01-70/05-10213/19 datë: 16.04.2019.

Sa i përket kërkesës të “Doni Fruits” tani më është kërkesë e njohur për ju. Ne kemi biseduar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe ata na kanë thënë që ne mund të vendosim vetë. Por kemi pa edhe disa mostra të komunave të tjera, që në ndërkohë do tua gjejë.

z. Perparim Ramusa; Propozoj që për këtë kërkesë ta kemi edhe një rekomandim nga drejtoria. Dhe po kërkoj që kërkesat që janë trajtuar më parë, mos i diskutojmë prapë edhe sot.

z. Ruzhdi Jashari; Nëse ne aprovojmë kërkesa të tilla, unë konsideroj se po bëjmë një gabim fatal, kjo për faktin e thjeshtë se nëse ky biznes dështon prona e Komunës konfiskohet, prandaj këso lloj kërkesash nuk bënë fare ma na ardhur këtu për shqyrtim. Është e pa falshme për Kuvendin nëse bën këso lloj gabimi.

z. Naim Zejna; Unë pajtohem me propozimin e Perparimit, që kërkesat që i kemi trajtuar, të mos i diskutojmë edhe sot sepse kemi një qëndrim për to. Sa i përket kësaj kërkesë unë jam që të shtyhet me arsyen që të kemi informata më të plota.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”,** lidhur me kërkesën e z. Bekim Sinanit, përfaqësues i firmës “DONI FRUITS” vendosi që nuk ka rekomandim, por që Kuvendi, të vendosë vetë drejtpërdrejt.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Prezantoi edhe kërkesat 2, 3 dhe 4 dhe propozoi që edhe këto kërkesa të shkojnë direkt në Kuvend.

2. z. Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z. Kemajl Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr.”Hamëz Jashari” p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-1225/20 datë: 16.01.2020.

3. z. Sali Beqa - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 datë: 09.03.2020.

4. z. Adem ramadani, (Kryetar i fshatit Raçak), Ankesë Nr.01-070/05-9498/20 datë: 16.06.2020.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”,** vendosi në paket për Kërkesat 2, 3, 4 të shkojnë në Kuvend pa rekomandim.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Prezantoi kërkesën 5 dhe hapi diskutimin për këtë kërkesë:

5. z. Rifat Imeri – Raçak, Kërkesa Nr.01-070/05-12154/20 datë: 15.07.2020.

z. Naim Zejna; Kërkesat me numër 5 dhe 6 janë të njëjtës natyrë, kështu që propozoj që ti trajtojmë së bashku. Por pyetja është a janë kryer të gjitha procedurat paraprake, që pastaj të mos të na del ndonjë problem. Unë jam që të kompensohen.

z. Perparim Ramusa; Diskutimi i Naimit ishte korrekt dhe unë po pajtohem, sepse arsyeja e marrjes së tokës është e qartë, është marrë për zgjerimin e rrugës publike, kështu që konsideroj se nuk ka asnjë arsye që të mos aprovohet.

z. Ruzhdi Jashari; Keni pas projekte të fushatave zgjedhore, dha tash hajde ti shpronësojmë këto prona që u janë marrë tokat pronarëve pa e planifikuar mirë edhe çështjen e shpronësimit. Po procedohet nga bishti e jo nga koka. Lidhur me shpronësimet, unë kam një pyetje konkrete, se pse nuk po bëhet shpronësimi përpara se të bëhet puna aty?

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”,** vendosi ti rekomandojë Kuvendit aprovimin e kërkesës Nr.01-070/05-12154/20 të z. Rifat Imerit nga fshati Raçak.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Prezantoi kërkesën 6 dhe hapi diskutimin për këtë kërkesë.

6. z. Ymri Imeri – Raqak, Kërkesa Nr.01-070/05-12156/20 datë:15.07.2020.

Meqenëse diskutime nuk kishte Kryesuesja konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, vendosi ti rekomandojë Kuvendit aprovimin e kërkesës Nr.01-070/05-12156/20 të z. Ymri Imerit nga fshati Raqak.**

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Prezantoi kërkesën 7 dhe hapi diskutimin për këtë kërkesë.

7. z. Gani Ademaj – Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-14165/20 datë:05.08.2020.

znj. Arbresha Sylaj; Përshëndetje, unë kam një pyetje lidhur me këtë kërkesë, meqenëse kjo është pronë private, a është kjo pronë e znj. Hamide Ademaj? sepse kërkesën e ka paraqitur dikush tjetër.

z. Perparim Ramusa; Kjo kërkesë është pa shumë kuartë se duhet të shtyhet dhe të kompletohet.


z. Naim Zejna; Edhe pse pala ka pas kohë të mjaftueshme që ta plotësoj kërkesën, nuk e ka bërë, kështu që kërkesa nuk është e kompletuar dhe nuk i plotëson kushtet. Është mirë që ta kemi të kuartë se po i rekomandojmë Kuvendit që kërkesa të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim”, vendosi ti rekomandojë Kuvendit që kërkesa Nr.01-070/05-14165/20, e z. Gani Ademaj nga fshati Petrovë të shtyhet deri në mbledhjen e radhës.**

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi në ora 10.52h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

